

KORPORATA E INVESTIMEVE SHQIPTARE
NJOFTIMI PARAPRAK I FITUESIT

DATA E TRANSMETIMIT: Ky Njoftim dërgohet me email më 04 Qershor 2026.

Korporata:	Korporata e Investimeve Shqiptare
Projekti i Investimit:	Rivitalizimi i Pallatit të Kongreseve
Konkursi i projektimit:	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Korporata e Investimeve Shqiptare
Titulli i Kontratës:	Zhvillimi nëpërmjet sipërmarrjes i objektit multi-funksional në pronën e Korporatës pranë Pallatit të Kongreseve, Tiranë

Ky Njoftim Paraprak i Fituesit (Njoftim) ju njofton për vendimin tonë për të lidhur kontratën e mësipërme. Transmetimi i këtij Njoftimi fillon periudhën e ankimimit. Gjatë periudhës së ankimimit ju mund të:

- a) kërkonte një informim në lidhje me vlerësimin e propozimit tuaj dhe/ose
- b) të paraqesni një ankesë në lidhje me vendimin për lidhjen e kontratës.

1. Propozuesi i suksesshëm:

Emri:	Shoqëria “KLAR sh.p.k.” me nënkontraktor të specializuar “Julian Beqiri & Herzog de Meuron Basel Ltd” + “Marsela Demaj” + “Michel Desvigne (MDP)” + “Gentian Shkurti” + “SUEB INDUSTRIES sh.p.k.” + “The Space Factory Ltd”
Adresa:	Rruga Dervish Hatixhe, Pallati Mozart, Kati 2, Zip Code 1001, Tiranë Email: xheni.konduri@klar.al
Përqindja e sipërfaqes së ofruar për Korporatën, e përloqatur mbi sipërfaqjen totale të metrave katrorë të objektit multifunksional të zhvilluar në pronën e Korporatës pranë Pallatit të Kongreseve, Tiranë (mbitokë dhe nëntokë), është:	46 % (dyzet e gjashtë përqind)

2. Renditja e rishikuar e propozueve të “Listës 4” është si më poshtë:

Nr.	Aplikuesit:	Përqindja e sipërfaqes së ofruar për Korporatën, e përloqatur mbi sipërfaqjen totale të metrave katrorë të objektit multifunksional të zhvilluar në pronën e Korporatës pranë Pallatit të Kongreseve, Tiranë (mbitokë dhe nëntokë), është:	Renditja (duke marrë në konsideratë dhe vendimin e Jurisë Ndërkombëtare)
1	Shoqëria “KLAR sh.p.k.” me nënkontraktor të specializuar “Julian Beqiri & Herzog de Meuron Basel Ltd” + “Marsela Demaj” + “Michel Desvigne (MDP)” + “Gentian Shkurti” + “SUEB INDUSTRIES sh.p.k.” + “The Space Factory Ltd”	46 %	Në vend të parë
2	Shoqëria “Bami Holding” me nënkontraktor të specializuar “MVRDV B.V sh.p.k.” + “AEI Progetti Srl” + “IRI sh.p.k.” + “Jason Bruges Studio Ltd” + “Charcoalblue International Ltd” + “Arup Engineering Trading as Ove Arup & Partners Ireland Ltd”	45.2 %	Në vend të dytë

3	Shoqëria “Gener 2” sh.p.k me nënkontraktor të specializuar “Studio GANG” + “AD-STAR shpk” + “Digi Print” + “Besart Papa” + “Rudina Papavasili”	45 %	Në vend të tretë
---	--	------	------------------

3. Arsyeja/at pse propozimi juaj ishte i pasuksesshëm – Nuk aplikohet

4. Si të bëni një ankesë

AFATI: Afati i fundit për dorëzimin e një ankesë lidhur me konkurimin që kundërshton vendimin për lidhjen e kontratës skadon në mesnatë, 9 Qershor 2026 (ora lokale).

Jepni emrin e kontratës, emrin e Propozuesit, detajet e kontaktit; dhe adresoni ankesën lidhur me konkurimin si më poshtë:

Kujdes: Njësia e Trajtimit të Ankesave

Korporata: Korporata e Investimeve Shqiptare

Adresa e emailit: competititon@aicorporation.al

Në këtë pikë të procesit të konkurimit, ju mund të paraqisni një ankesë lidhur me konkurimin duke kundërshtuar vendimin për lidhjen e kontratës. Ju nuk keni nevojë të keni kërkuar ose marrë një informim para se të bëni këtë ankesë. Ankesa juaj duhet të dorëzohet dhe të merret nga ne përpara përfundimit të periudhës së ankimit.

Informacione të mëtejshme:

Për më shumë informacion, shihni rregulloren përkatëse të procedurave konkurruese të Korporatës. Ju duhet t'i lexoni këto dispozita përpara se të përgatitni dhe paraqisni ankesën tuaj.

Në përmbledhje, ekzistojnë katër kërkesa thelbësore:

1. Ju duhet të jeni një 'palë e interesuar'. Në këtë rast, kjo do të thotë se ju jeni një Propozues i cili ka dorëzuar një propozim në këtë konkurim, dhe jeni marrësi i një Njoftimi paraprak për lidhjen e kontratës.
2. Ankesa mund të kundërshtojë vetëm vendimin për lidhjen e kontratës.
3. Ju duhet të paraqisni ankesën brenda afatit të lartpërmendur.
4. Ju duhet të përfshini, në ankesën tuaj, të gjithë informacionin e kërkuar nga rregulloren përkatëse të procedurave konkurruese të Korporatës.

5. Periudha e ankimit

AFATI: Periudha e ankimit do të përfundojë në mesnatën e 9 Qershor 2026 (ora lokale). Periudha e ankimit zgjat pesë (5) ditë pas datës së transmetimit të këtij Njoftimi paraprak për lidhjen e kontratës. Periudha e ankimit mund të zgjatet. Nëse kjo ndodh, ne do t'ju njoftojmë për zgjatjen.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë Njoftim, ju lutemi mos hezitoni të na kontaktoni.